Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/03-13713/26
Kaçanik, 11.06.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II (dytë) Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2026, mbajtur me 11 Qershor 2026. Mbledhja u mbajt në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë, në ditën e enjte, me fillim pune në ora 11:00.
Pjesëmarrës të kësaj mbledhje nga KK ishin 18 anëtarë, sipas regjistrit që kanë nënshkruar. Në këtë mbledhje munguan: 3 anëtarë.
Nga Ekzekutivi i Komunës ishin: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, drejtorë të drejtorive, ndërkaq nga zyrtarët e komunës Zyrtarja e Informimit, Zyrtari i IT, Zyrtarja e Kuvendit.
Në këtë mbledhje morën pjesë edhe:
Përfaqësues nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK,
Mysafirë të ftuar dhe qytetarë të komunës.
Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë

Mbledhjen e Kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, Selajdin Troni, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Sot po mbajmë mbledhje solemne për nderë të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut. Në nderim te të gjithë të rënëve për liri, iu ftoj të mbajmë një minutë heshtje.
Vazhdojmë me mbledhjen sipas kësaj,

Agjenda

1. Hapja e mbledhjes, fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi;
3. Fjala e përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së.
4. Fjala e mysafirëve të ftuar;
5. Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës.

Në vazhdim, në përkujtim të ngjarjeve të shënuara, fjalën e morën sipas Agjendës:

1. Fjala e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni;

Të nderuar anëtar të kuvendit,
I nderuar kryetar, Sabedin Vishi,
I nderuar nënkryetar i komunës, Xhelal Dema,
I nderuar, Ilaz Ramajli,
I nderuar komandant, Xhabir Elezi,
Të nderuar të pranishëm,
Të nderuara Familje të dëshmorëve, të nderuar veteranë dhe invalidë të luftës së UÇK,
Të nderuar familje të martirëve,
I nderuar Jashar Selimi, Kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Luftës në Kaçanik.
Si Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçaniku, por edhe si djali i heroit të kombit, e ndjej peshën dhe nderin e veçantë të flas sot para juve. Kjo ditë nuk është vetëm një datë historike, është kujtim i të gjallëve, i atyre që dhanë gjithçka që ne sot të jetojmë të lirë. Sot në këtë ditë të shenjtë për komunën tonë, kujtojmë me krenari dhe respekt 11 Qershorin -Ditën e Çlirimit të Kaçanikut. Kjo është dita kur u kurorëzua sakrifica e një populli që nuk u përkul para pushtimit, kjo është dita kur ;liria fitoi mbi dhunën dhe padrejtësinë.
Me respektin me të madh përulemi para dëshmorëve të kombit, të cilët me gjakun e tyre shkruan historinë e lirisë sonë. Kujtojmë me nderim komandantët e brigadës Agim Bajrami dhe Qamil Ilazi, të cilët me trimëri, vendosmëri dhe përkushtim udhëhoqën luftëtarët në mbrojtje të popullit dhe atdheut. Sot kujtojmë edhe komandantin legjendar Adem Jashari dhe familjen Jashari, e cila u bë themel i sakrificës për liri. Qëndresa e tyre në Prekaz mbetet frymëzimi i përjetshëm për brezat që vijnë. Nga sakrifica e tyre, mori forcë r gjithë lufta çlirimtare e popullit. Mirënjohje të veçantë u shprehim familjeve të dëshmorëve. Asnjë fjalë nuk mundet të zëvendësoj mungesën e me të dashurve tuaj. por populli i Kosovës do të jetë gjithmonë krenar për sakrificën që keni dhënë për lirinë tonë. Pa ashtu sot kujtojmë me dhimbje e krenari të gjithë shokët e rënë nëpër beteja. Ata lanë familjet, ëndrrat dhe jetën e tyre në altarin e lirisë. Emrat e tyre janë pjesë e historisë sonë dhe do të jetojnë gjithmonë në kujtesën e kombit. Shumë luftëtarë nuk humbën vetëm shokët e tyre të armës, ata humbën vëllezër, baballarë dhe miqtë të jetës. Këto plagë nuk janë shëruar kurrë plotësisht, por ata janë kthyer në forcë për të ruajtur amanetin e tyre.
Sot nderojmë çdo prind që sakrifikoi për lirinë e Kosovës. nderojmë çdo familje që përballoi dhimbjen me dinjitet e krenari, nderojmë çdo bashkëluftëtarë që vazhdon të mbaj në zemër kujtimin e shokëve të rënë.
Të nderuar veteranë dhe invalidë të luftës
Ju bartët barrën me të rëndë në ditët me të vështira të atdheut. Shumë prej jush ende bartin plagë në trup dhe në shpirt. Liria që gëzojmë sot është rezultat i mundit, sakrificës dhe qëndresës suaj. Prandaj. çdo përpjekje për të nënçmuar, ose për të harruar kontributin tuaj, është e padrejtë dhe e papranueshme. Veteranët dhe invalidët

e luftës meritojnë respekt, dinjitet dhe mirënjohje të përhershme. Në këtë ditë kujtimi, nuk mund të mos shprehim solidaritetin tonë edhe me krerët e luftës që po përballën me proceset gjyqësore në Hagë. Ne besojmë se lufta e UÇK-së ishte luftë çlirimtare dhe e drejtë, e zhvilluar për lirinë dhe dinjitetin e popullit tonë. Duke respektuar drejtësinë dhe institucionet, ne njëkohësisht mbrojmë të vërtetën historike të luftës sonë çlirimtare.

Të dashur qytetarë,

Liria nuk është vetëm trashëgimi, ajo është përgjegjësi. Brezat që vijnë duhet të mësojnë se kjo liri u fitua me gjak, sakrificë dhe dashuri për atdheun. Detyra jonë është të ruajmë, ta forcojmë dhe të zhvillojmë shtetin tonë me të njëjtin përkushtim që dëshmorët e mbrojtën me jetën e tyre.

Në emër të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut dhe në emrin tim si Kryesues i Kuvendit, ju Uroj Ditën e Çlirimit të Komunës.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit!

Nderim i përhershëm familjeve të tyre!

Respekt për veteranët dhe invalidët e luftës!

Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit: Vazhdojmë me Fjalimin e Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi.

2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës, Sabedin Vishi

Shumë të nderuara familje të dëshmorëve, veteranë e invalidë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal z. Selajdin Troni,

I nderuari ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës Haz Ramajli,

I nderuari përfaqësuesi i OJQ të dala nga lufta, z. Xhabir Elezi,

I nderuari z. Deli Krivanjeva,

I nderuara Kryetar i OJQ të dala nga lufta, z. Jashar Selimi,

I nderuar nënkryetar i komunës, Xhelal Dema,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

Të nderuar pjesëmarrës tjerë

Të dashur qytetarë të Kaçanikut,

Sot po shënojmë një përvjetor të gëzimit, një përvjetor të lindjes së shpresës dhe jetës për atdheun tonë.

Dita e Çlirimit, 11 Qershori 1999, ishte një ditë e bekuar, një ditë që shënon triumfin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të popullit tonë liridashës dhe të aleatëve tanë ndërkombëtarë, të prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Muaji qershor, në historinë tonë kombëtare, është muaj i krenarisë dhe i lavdisë. Ishte 10 Qershori i vitit 1878 që shënoi themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke krijuar platformën politike të aspiratave tona kombëtare. Më pas erdhën shumë qershor sakrifice, për të mbërritur tek qershori i lirisë – qershori i triumfit të Kosovës, i fituar me gjakun dhe përkushtimin e vajzave dhe djemve më të mirë të këtij vendi.

Kaçaniku, mund të jetë më i vogël për nga territori dhe numri i banorëve në Kosovë, por zë një vend të veçantë në historinë e rezistencës dhe të luftës për liri. Kjo komunë i dha Kosovës shumë dëshmorë e martirë, të prirë nga komandantët Agim Bajrami e Qamil Hazi, të cilët sakrifikuan gjithçka që ne sot të jetojmë të lirë. Prandaj, kemi obligim të përhershëm që të ruajmë kujtimin për ta dhe të përcjellim tek brezat e rinj vlerat për të cilat ata ranë.

Në këtë ditë të shenjtë për qytetin tonë, shprehim mirënjohjen më të thellë për dëshmorët, martirët, veteranët dhe të gjithë ata që kontribuuan në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Kujtojmë me respekt edhe drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke besuar fuqishëm në drejtësinë dhe të vërtetën e luftës sonë çlirimtare, e duke i parë së shpejti në Kosovë pranë familjeve dhe pran atdheut të tyre.

Të nderuar të pranishëm

Liria nuk ishte vetëm një kujtim i së kaluarës; ajo është përgjegjësi për të tashmen dhe amanet për të ardhmen. Detyra jonë sot është të ndërtojmë një Kaçanik dhe një Kosovë më të zhvilluar, më të drejtë dhe më të begatë për të gjithë qytetarët tanë.

Duke përkujtuar me nderim të gjithë ata që sakrifikuan për këtë ditë, le të punojmë së bashku që ideali i tyre për një Kosovë të lirë, demokratike dhe me perspektivë të vazhdojë të jetë udhërrëfyesi ynë.

Urime 11 Qershori – Dita e Çlirimit të Kaçanikut!

Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të kombit!

Qoftë i përhershëm kujtimi dhe vepra e tyre sublime!

Ju faleminderit dhe edhe njëherë, Gëzuar Dita e Çlirimit të Komunës së Kaçanikut!

Kryesuesi i Kuvendit: Ju falënderoj kryetar për fjalën, kalojmë të

3. Fjalimi i përfaqësuesit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës-UÇK-së,

Fjalën e ka përfaqësuesi i veteranëve të luftës, komandanti Xhabir Elezi.

z. Xhabir Elezi- përfaqësues i veteranëve të luftës së UÇK-së

Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidë, veteranë të luftës, përfaqësues të institucioneve të komunës së Kaçanikut dhe të gjithë të pranishmit tjerë.

Sot jemi mbledhur këtu me krenari dhe respekt të thellë për të shënuar Ditën e Çlirimit të Kaçanikut, një nga datat me të rëndësishme të historisë së qytetit tonë dhe të Kosovës. Data 11 Qershor 1999 sot po bëhen 27 vite, kur njësitë çlirimtare të brigadës 128 'Agim Bajrami", me guxim, sakrificë dhe vendosmëri e çliruan Kaçanikun nga forcat okupatore serbe, duke u dhënë fund një periudhe të rëndë, duke hapur rrugën e lirisë. Liria që gëzojmë sot ka një çmim të shenjtë, me gjakun dhe jetën e bijëve dhe bijave me të mira të këtij vendi. Për çlirimin e këtij vendi ranë dëshmorë 95 dëshmorë, të cilët me sakrificën e tyre u bënë themel i lirisë. Emrat dhe veprat e tyre do të mbetën përherë udhërrëfyes për brezat që vijnë. Sot kemi lirinë e pakufishme dhe përulëm para familjeve të dëshmorëve, të invalidëve dhe veteranëve

të luftës për sakrificën dhe kontributin e krenarisë kombëtare. Detyra jonë është, të ruajmë dhe të forcojmë lirinë për të cilën u flijuan dëshmorët. Kështu, duhet ruajtur gjithçka që dhanë për ne. Për këtë ditë të shenjtë, kujtimet dhe krenaria, na kujtojnë se liria nuk ishte dhuratë, por rezultatet e sakrificës të madhe të dëshmorëve dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës- UÇK-së.
Lavdi dëshmorëve të brigadës 162 Agim Bajrami!
Lavdi për të gjithë martirët e kombit!
Urime Dita e Çlirimit Kaçanikas!
Kryesuesi i Kuvendit: Ju falënderoj për fjalën, komandant Xhabir Elezi, ia kalojmë fjalën mysafirit të ftuar, Ilaz Ramajli- ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

z. Ilaz Ramajli- ish Kryetar i Kuvendit të Kosovës: Përshëndetje kryetar i komunës Sabedin Vishi, Kryesues i Kuvendit, Selajdin Troni, përfaqësues të partive politike, ju uroj Ditën e Çlirimit të Kaçanikut - 27 vjetorin e çlirimit. Njëherë ju falënderoj për ftesën që me keni bërë, me marrë pjesë në këtë mbledhje solemne. Besoj se kjo është një ditë e cila të gjithë neve duhet të na shërbej për reflektim, dhe kujtim të gjithë atyre që e dhanë jetën për Republikën e Kosovës, e dhanë jetën për lirinë e këtij vendi, e dhanë jetën për krijimin e këtij shteti që ne e gëzojmë sot. Në fakt gjaku i këtyre grave dhe burrave të cilët nuk kursyen asgjë, duke përfshirë edhe jetën e tyre, gjendet themelet e këtij shteti që ne po e gëzojmë sot dhe që po jetojmë në liri. Gjithashtu është ditë kur duhet të reflektojmë për familjarët e tyre, të cilët humbën me të afërmit e tyre, por asnjëherë nuk u ankuan, por u ndien krenarë. Duhet të kujtojmë edhe invalidët e luftës, dhe të mendojmë se a thua se po ju kushtojnë kujdes kjo shoqëri që ata e meritojnë. Duhet të kujtojmë edhe gjithë pjesëmarrësit e UÇK, por edhe të gjithë ata nga viti 1990 që kontribuuan që ne sot të jetojmë të lirë dhe të pavarur. Konsideroj se kjo është një ditë kur duhet të reflektojmë për atë se cila është ardhmëria jonë, çka do të bëjmë në të ardhmen, si do ta ruajmë amanetin e atyre që dhanë jetën për lirinë dhe si do ta bëjmë Kosovën një shtet me të mirë, me të përshtatshëm për jetesën e qytetarëve të saj dhe kthimin e atyre që për shumë shkaqe e kanë lëshuar Kosovën. Duhet të reflektojmë se sa i rëndësishëm është uniteti i jonë për çështjet kyçe, që sot e mundojnë Kosovën dhe lutemi që elita politike në Kosovës për çdo problem që e kemi sot në Kosovë, të gjejë rrugëzgjidhje. Ju falënderoj për ftesën dhe ju uroj juve dhe gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut 11 Qershorin- Ditën e Çlirimit të Komunës së Kaçanikut.
Kryesuesi i Kuvendit: Ju falënderoj për fjalën, z. Ilaz Ramajli, ia kalojmë fjalën përfaqësuesve të subjekteve politike.

4.Fjalimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës;

Fjalën e ka një përfaqësues nga subjekti politik nga Partia Demokratike e Kosovës

3.1 Nga Subjekti Politik, Partia Demokratike e Kosovës, fjalë rasti mbajti anëtarja e KK, Elona Gjini

znj. Elona Gjini: I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal- z. Selajdin Troni
I nderuar Kryetar i Komunës . Z. Sabedin Vishi
Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal .
Te Nderuara familje të dëshmoreve .
Te nderuar veteran e invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe veprimtar të çështjes sonë kombëtare,
Të dashur qytetar të Komunës se Kaçanikut
Është nder për mua të ju uroj këtë ditë të veçantë, Ditën e çlirimit përmes kësaj seance solemne, e cila sot më shumë se kurrë ka madhështinë dhe solemnitetin e saj. Sepse pikërisht sot 27 vite me parë, kjo ditë na kujton rilindjen e shpresës për ndërtimin e jetës në Kosovën tonë të lirë.
Mbi të gjitha, sot është dita kur ne duhet te kujtojmë. e të mos harrojmë sakrificën e madhe të popullit tonë , e gjithë të rënëve për liri, që me veprën e tyre sublime ndryshuan kahjen e historisë, i bënë ëndrrat tona realitet dhe i dhanë kuptim jetës .
Me përkulje ndaj gjithë të rënëve për liri, në emrin tim personal si dhe te grupit parlamentar te Partisë Demokratike te Kosovës , ju uroj të gjithëve:
- Gëzuar Ditën e Çlirimit të Kaçanikut!
Dita e çlirimit, është dita kur sakrifica u kthye në liri, është dita kur gjaku i dëshmorëve, mundi i luftëtarëve dhe qëndresa e popullit tonë morën kuptimin më të madh: lirinë e Kaçanikut dhe të Kosovës.
Unë jam e lindur , një vit pas çlirimit të Kosovës. Nuk e kam përjetuar luftën me sytë e mi, por jam rritur me kujtimin e saj, me rrëfimet e familjes, me dhimbjen dhe krenarinë që bart çdo shtëpi shqiptare. Jam rritur duke e ditur se liria që gëzojmë sot nuk na është dhuruar, por është fituar me sakrificë, me guxim dhe me jetë njerëzish.
Si asambleiste në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut, e zgjedhur nga qytetarët dhe si përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, ndiej detyrë që zëri im sot të jetë zë falënderimi, zë respekti dhe zë zotimi.
Prandaj ky përvjetor që përfshinë me shume se çerek shekulli, është një ditë e bekuar, e cila na sjellë në kujtesë heroizmin e Ushtrisë tonë të lavdishme, heroizmin e djemve dhe vashave tona për organizimin më emblematik ushtarak që kemi kaluar, për organizimin e luftës çlirimtare, që fuqizoi në mënyrën më shembullore edhe qëndresën tonë paqësore; duke zgjuar jo vetëm energjitë e popullit, por edhe ndërgjegjen e faktorit ndërkombëtar, civil e ushtarak, për zhbërjen e makinerisë pushtuese të okupatorit.
Kaçaniku ka qenë gjithmonë vatër e atdhedashurisë dhe qëndresës.. Në ditët më të vështira, bijtë dhe bijat e kësaj ane nuk u përkulën. Ata zgjodhën rezistencën, zgjodhën luftën për dinjitet, zgjodhën rrugën e lirisë. Përkushtimi ynë për ndërtimin e mirëqenies së përgjithshme të qytetarit është zotim institucional e kombëtar për të sotmen dhe për gjeneratat e reja. Ndërsa sot nderojmë të kaluarën, ne gjithashtu duhet të shohim drejt së ardhmes me shpresë dhe përkushtim, që kjo dite te mos mbetet vetëm një moment kujtimi, por te jete edhe një obligim moral për secilin prej nesh që të punojmë për zhvillimin e komunës sonë, për mirëqenien e qytetarëve dhe për forcimin e unitetit, paqes dhe mirëkuptimit. Liria që gëzojmë sot duhet të na frymëzojë që të

punojmë me përgjegjësi, ndershmëri dhe përkushtim në shërbim të qytetarëve. Dhe respekti më i madh për ata që dhanë jetën për liri është ndërtimi i një komune më të zhvilluar dhe me mundësi të barabarta për të gjithë. Le të ruajmë gjithmonë kujtesën për sakrificën e popullit shqiptar për liri dhe ta kultivojmë frymën e unitetit, solidaritetit dhe përparimit që e meriton Kaçaniku ynë. Gëzuar 11 Qershori - Dita e Çlirimit të Kaçanikut dhe 12 Qershori - Dita e Çlirimit të Kosovës!
Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit!
Nderim dhe respekt për veteranët dhe invalidët e UÇK-së, familjet e dëshmorëve
Respekt për veprimtarët e çështjes sonë kombëtare te të gjitha kohërave dhe gjithë atyre që kontribuuan për lirinë e Kosovës.
Ju faleminderit shumë!

Kryesuesi i Kuvendi: Faleminderit znj. Elona, vazhdojmë me Lëvizjen Vetëvendosje. Fjalën e ka një përfaqësues nga subjekti politik nga i LVV.

3.2 Nga Subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e mori, shefja e grupit, Kadrije Lika-Troni

znj. Kadije Lika Troni: I nderuari Kryetar i Komunës, z. Sabedin Vishi,
I nderur Nënkryetar i Komunës, z. Xhelal Dema,
I nderuari Kryesues i Kuvendit, z. Selajdin Troni,
I nderuari z. Ilaz Ramajli,
I nderuari z. Deli Krivanjeva,
Të nderuar dhe shumë te respektuara familje të dëshmorêve, veteranë dhe invalidë të luftës,
Te nderuar anëtarë të ekzekutivit,
Të nderuar anëtarë të KK,
Të nderuar qytetarë te komunes se Kaçanikut,
Zonja dhe Zoterinjë,
Sot ne Ditën e Çlirimit, jemi mbledhur këtu me respekt dhe krenari për të kujtuar kapituj me të rëndësishëm të historisë sonë.
Kaçaniku e njeh mirë çmimin e lirisë. Historia e tij është histori qendrese, është historia e brezave që nuk e pranuan padrejtësinë dhe në momentet vendimtare zgjodhen sakrificen përballë nënshtrimit Data 11 Qershori është dita ku kujtojmë me mirënjohje dëshmorët e kombit, martirët e lirisë dhe heronjtë dhe herionat e Kaiçanikuit. Një nderim I veçantë shkon për familjet e dëshmorëve, te cilët e shndërruan dhimbjen në forcë dhe krenarinë në shembull nder breza. Po ashtu shprehim respektin tonë per veteranët dhe invalidët e luftës të cilët mbeten dëshmia me e gjallë e sakrificës për lirinë e Kosovës. Sot kujtojmë të gjithë burrat dhe gratë që dhanë kontribut nder breza që ne sot të jetojmë të lirë. Mirënjohje i kushtojmë edhe mbështetjes së aleatëve tanë ndërkombëtarë dhe rolin vendimtarë të NATO-s, e cila qendroj ne anën e një populli që kërkonte te drejten për te jetuar te lirë në vendin e vet. Sot, derisa kujtojmë rrugët tona drejt lirisë, nuk mundemi te mos shprehim solidaroitetin tonë me udhëheqelësit e UÇK-së që vazhdojnë të përballen me procese në Hagë. Ne besojmë në drejtësi, por njëkohësisht besojmë në pastërtinë e luftes së

UÇK-së dhe në të drejtën historike të popullit tonë për liri. Të nderuar qytetarë, liria që gezojmë sot, është përgjegjësi për të ardhmen, përgjegjësi për të ruajtur shtetin, për ta forcuar demokracinë, dhe për të ndërtuar Kosovën me dinjitet, ashtu siç e ndërtuan ata që sakrifikuan për të. Ne këte ditë kujtimi dhe krenarie, lë të përulemi para veprës se tyre, dhe të zotohemi se amaneti i tyre do të mbetet gjithmonë i gjallë në ndërgjegjën tonë kombëtare. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit, nderim hëronjëve dhe heroinave të Kacaniku, respekt për veteranët, invalidët e luftës, familjeve te dëshmorëve. Urime për të gjithë 11 Qershori -Dita e Çlirimit.
Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendi: Faleminderit znj. Kadrije, vazhdojmë me Lidhjen Demokratike të Kosovës-LDK. Fjalën e ka një përfaqësues nga subjekti politik nga i LDK.

3.3 Nga Subjekti politik, Lidhja Demokratike të Kosovës, fjalë rasti mbajti, shefja e grupit, Ardita Rrahmani

znj. Ardita Rrahmani: Të nderuar qytetarë të Kaçanikut,

I nderuar Kryetar, Kryesues, staf ekzekutiv, i nderuar z. Ramajli, z. Elezi dhe z. Krivanjeva.
Të respektuar familjarë të dëshmorëve, veteranë, invalidë të luftës, përfaqësues të institucioneve dhe të pranishëm, Të gjithë ne bashkë, të mbledhur për të shënuar një nga datat më të rëndësishme në historinë e qytetit tonë – 11 Qershorin, Ditën e Çlirimit të Kaçanikut tonë, Kaçanikut të Idriz Seferit, Kaçanikun e Sali Bajres, Kaçanikun e Bedri Kyqykut, Agim Bajramit e Qamil Ilazit. Datat si kjo e sotme na e sjellë në kujtesë te fresket sakrificën, guximin dhe përkushtimin e burrave e grave më të mirë të këtij vendi, të cilët dhanë gjithçka për çka sot kemi. Me respektin më të madh përulemi para dëshmorëve të kombit dhe të gjithë atyre që kontribuuan në rrugën e lirisë. Sakrifica e tyre mbetet udhërrëfyes për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Të rënët mësuan të gjallët se liria nuk dhurohet, fitohet me përkushtim, qëndresë dhe dashuri për atdheun. Na mësuan se për atdhe edhe vetflijohet. Dita e Çlirimit nuk është vetëm një kujtim i së kaluarës, por edhe një përgjegjësi për të ardhmen. Ne duhet të punojmë çdo ditë për një Kaçanik më të zhvilluar, më të drejtë dhe më te bashkuar, një Kaçanik për të cilin secili nga ne duhet tejkalua veten dhe bindjet e tona, por gjithmonë duke ruajtur vlerat për të cilat u sakrifikuan parardhësit. Në këtë ditë të shenjtë, lë të bashkohemi në nderimin e veprës së tyre dhe të zotohen se do të vazhdojmë të ndërtojmë një shoqëri me dinjitet, mirëqenie dhe perspektivë për të gjithë qytetarët.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit!
Nderim për të gjithë veteranët e luftetarët e Ushtrise Çlirimtare te Kosoves.
E gëzofsh ditën e Çlirimit i joni Kaçanik. E gëzofsh ditën e Çlirimit e jona Kosovë.

Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendi: Faleminderit znj. Ardita, vazhdojmë me Vizionin për Zhvillimin e Kaçanikut-VZHK. Fjalën e ka Heset Malsiu. Fjala për ju komandant.

3.4 Nga Subjekti Politik, Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut, fjalë rasti mbajti shefi i grupi, Heset Malsiu.

z. Heset Malsiu: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm në këtë seancë solemne të Kuvendit të Komunës, përshëndetje të veçanta e të përzemërta për familjet e dëshmorëve, luftëtarët e UÇK-së dhe për të gjithë kaçanikasit, kudo që ndodhen.
Jam i vetëdijshëm se sot është ditë feste dhe, në raste të tilla, ekzistojnë një mijë arsye për të festuar. Megjithatë, sot, njëzet e shtatë vite pas çlirimit, kur diskursi publik ka arritur pikun e mohimit dhe fyerjes së vlerave që përfaqësojnë kontributin në çlirimin e vendit; pra, sot, kur me aq lehtësi fyhet familja e Komandantit Adem Jashari, kur fyhen lotët e nënës Rukë e. përmes saj. lotët e secilës nënë që i dha dëshmor kësaj toke; sot, kur jo vetëm gjykatat e krijuara dhe të motivuara politikisht tentojnë t'i kriminalizojnë udhëheqësit e luftës e. përmes tyre, të gjithë luftëtarët dhe vetë luftën çlirimtare, ndjenjat e mia të brendshme më shumë i thërrasin arsyes sime të protestojë sesa të festojë.
Dilema ime është nëse luftëtarët duhet të protestojnë duke u përballur me këtë diskurs ofendues e përçmues, apo të heshtin në shenjë proteste, me bindjen se fjalët ofenduese do të zbehen me kohën, ndërsa vepra e tyre për liri do të mbetet e shkruar në ndërgjegjen dhe historinë e kombit.
Të nderuar të pranishëm,
Ditë si kjo që po shënojmë sot na bëjnë të reflektojmë dhe na kthejnë kujtimet tona në retrospektivë, atje ku nuk mund të mos e kujtojmë shembullin e sakrificës dhe qëndresës së Ismail Rakës përballë torturave dhe mizorisë çnjerëzore, duke mbrojtur me jetën e tij emrat dhe veprimtarinë e shokëve, tek të cilët besonte se do ta vazhdonin rrugën e idealit deri në realizimin e amanetit të tij.
Nuk mund ta kujtojmë luftën për liri e të mos e kujtojmë forcën shpirtërore të nënës Elife, atëherë kur ishte pranë trupave të tre dëshmorëve dhe, kur hordhitë serbe iu afruan e me egërsi e pyetën:"Cili nga këta është djali yt?", ajo, e papërkulur, iu përgjigj: "Të tre këta janë djemtë e mi, por Agimin e kam lindur nga ky bark."
Se liria i ka themelet mbi gjakun e dëshmorëve, na e sjell fuqishëm në kujtesë paralajmërimi që Komandanti i bëri rënjes së tij. Kur ditë më herët para se të binte në fushën e nderit, dhjetëra bashkëluftëtarëve u tha:"Më 14 maj çlirohet Kosova." Parashikim ky, pikërisht për ditën kur gjaku i tij do ta ujiste tokën e Kosovës.
Se ku e kishte burimin ndjenja e gatishmërisë së luftëtarëve për sakrificë dhe flijim, besoj se mjaftueshëm dhe bindshëm na e dëshmon gjoksi i dëshmorit Avdulla Baftiu, mbi të cilin, pas rënies në fushën e nderit, qëndronte fotografia e fëmijëve të tij, e cila edhe sot sikur na përcjell fuqishëm porosinë:"Unë u flijova që brezi i ri ta gëzojë lirinë."
Përmes shpalosjes së këtyre sekuencave të kujtimeve dua t'i porosis, sidomos brezin e pasluftës, që pavarësisht se ku e japin kontributin e tyre, qoftë edhe në politikë, ta kenë parasysh dhe të mos harrojnë kurrë se vlera mbi të cilën u ngrit liria dhe shtetësia e vendit tonë është Ushtria Çlirimtare e Kosovës.
Prandaj, në këtë ditë dhe nga ky kuvend, i bëj thirrje rinisë që të mos lejojë askënd t'ua mohojë të drejtën për të qenë të rreshtuar në anën e drejtë të historisë, përkrah vlerave të UÇK-së.

Ky rreshtim sot nuk kërkon sakrificë; kërkon vetëm vetëdije të lartë kombëtare. Kërkon të kuptojmë se nuk mund të ketë mision të shenjtë të dëshmorit, e të quhen kriminelë ata që e realizuan atë mision dhe amanet.
Lavdi dëshmorëve të kombit!
Respekt veprimtarisë dhe veprimtarëve ndër breza!
Respekt dhe mirënjohje për të gjithë luftëtarët, me apo pa plagë lirie!

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit Heset Malsiu. Anëtari nga AAK nuk është prezentë.
Atëherë, i falenderoj edhe njëherë të gjithë luftetarët e lirisë. Lavdi e përjetshme të gjithë dëshmorëve të kombit, respekt të veçantë të gjithë atyre që dhanë kontribut të veçantë për liri. Me emocion, dhimbje dhe krenari, iu uroj edhe një herë Ditën e Çlirimit të Komunës së Kaçanikut.

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, e konstatoj përfundimin e mbledhjes në ora 10:40, për të vazhduar me agjendat tjera.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
MMalsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA